

REPUBLIKA E SHQIPERSISE
SHOQERIA TREGETARE
"ALBIT CONSTRUCTION" SH.P.K.
LAC

VENDIM NR 21, DATE 28.04.2021
I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE TREGTARE
"ALBIT CONSTRUCTION" SH.P.K. LAC

Ne Lac, sot ne date 28, muaji Prill, viti 2021, u mblodh Asambleja e Ortakeve e Shoqerise Tregtare "ALBIT CONSTRUCTION" Sh.p.k. Lac , ne seline e saj dhe mori ne shqyrtim rendin e dites :

- a) Miratimin e pasqyrave financiare te vitit ushtrimor 2020 te mbyllura me 31 Dhjetor 2020 ;
- b) Zmadhimin e kapitalit te Shoqerise Tregtare "ALBIT CONSTRUCTION" Sh.p.k. Lac.

Asambleja e Ortakeve, pasi u njoh me rendin e dites

VEREN SE :

Shoqeria Tregtare "ALBIT CONSTRUCTION" Sh.p.k. Lac, eshte e rregjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit, date 25.01.2007, me kaipital 42,000,000 leke i zoteruar nga Ortaket ne keto raporte :

1. Luan Marnoj 39,900, 000 leke , me perqindje pjesemarrje 95 %;
2. Roland Kocli 2,100, 000 leke , me perqindje pjesemarrje 5 %;

Administrator i shoqerise eshte z. Roland KOCLI

Gjate shqyrtimit te veprimtarise tregtare dhe tregueseve financiare te shoqerise "ALBIT CONSTRUCTION" Sh.p.k. Lac, Asambleja e Ortakeve konstaton se per per te patur nje vazhdimesi dhe siguri te veprimtarise, gjendjen e rezervave dhe fitimeve te pa shperndara me 31 Dhjetor 2020 ti kaloje: 1) per zmadhim te kapitalit aksionar te kesaj shoqerise me vleren 58,000,000 Leke, 2) per shtim te rezervave ligjore 2,200,000 leke, dhe 3) diferenca prej 4,555,759 leke te mbetet gjendje per rezerva te tjera, ne baze te Statutit & Aktit te Themelimit te shoqerise, Ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe dispozitave fiskale ne fuqi.

Per keto arsye,Asambleja e Ortakeve e Shoqerise Tregtare "ALBIT CONSTRUCTION" Sh.p.k. Lac, pas shqyrtimit te rendit te dites :

VENDOSI :

- Miratimin e llogarive vjetore te Shoqerise Tregtare "ALBIT CONSTRUCTION" Sh.p.k. Lac per vitin financiar 2020 te mbyllur me date 31.12.2020;
- Kalimin e rezervave dhe fitimeve te passhperndara gjendje sipas bilancit te mbyllur me 31 Dhjetor 2020 per: 1) zmadhimin e kapitalit aksionar te shoqerise me vleren 58,000,000 leke, 2) shtim te reserves ligjore me 2,200,000 leke , dhe 3) diferenca ne vleren prej 4,555,759 leke te mbetet gjendje per rezerva te tjera - investime ;
- Caktimin e z. Lavdimir FUSHA, anetar i Insitutit te Eksperteve Kontabel te Regjistruar, me Nr.Licence 97 date 10.01.2001, per vleresimin e zmadhimit te kapitalit aksionar me rezervat dhe fitimet e pa shperndara, gjendje sipas bilancit te mbyllur me 31 Dhjetor 2020;
- Caktimin e z.Lavdimir FUSHA per auditimin e pasqyrave financiare te vitit ushtrimor 2021;
- Depozitimin e ketij vendimi prane Qendres Kombetare te Biznesit si dhe Drejtorise Rajonale Tatimore Lezhe.

ASAMBLEJE E ORTAKEVE E SHOQERISE TREGETARE

"ALBIT CONSTRUCTION" SH.P.K LAC

ROLAND KOCLI



LUAN MARNOJ



REPUBLIKA E SHQIPERSISE
SHOQERIA TREGETARE
"ALBIT CONSTRUCTION" SH.P.K.
LAC

VENDIM NR 22, DATE 10.05.2021
I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE TREGTARE
"ALBIT CONSTRUCTION" SH.P.K. LAC

Në Lac, sot në datën 10, muaji Maj, 2021, u mbledh Asambleja e Ortakeve e Shoqërisë Tregtare "ALBIT CONSTRUCTION" Sh.p.k. Lac, në selinë e shoqërisë, për shqyrtimin e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Raportit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar për vlerësimin e rezervave dhe fitimeve të pashpërndara për zmadhimin e kapitalit aksionar të Shoqërisë, të datës 08 Maj 2021 të përgatitur nga z. Lavdimir FUSHA, Ekspert Kontabël i Regjistruar;

Asambleja e Ortakeve e Shoqërisë, pasi u njoh me rendin e ditës;

V Ë R E N S E

Shoqeria Tregtare "ALBIT CONSTRUCTION" Sh.p.k. Lac, është e regjistruar pranë Qendres Kombëtare të Biznesit, date 25.01.2007, me kapital 42,000,000 leke i zotëruar nga Ortaket në keto raporte :

1. Luan Marnoj 39,900,000 leke , me përqindje pjesëmarrje 95 %;
2. Roland Kocli 2,100,000 leke , me përqindje pjesëmarrje 5 %;

Administrator i shoqërisë është z. Roland KOCLI

Ortaket e kësaj shoqërie janë z. Luan MARNOJ dhe z. Roland KOCLI. Kapitali aksionar i kësaj shoqërie është 42,000,000 (Dyzet e dy milion) Lekë. Kështu, z. Luan MARNOJ zotëron 95 % të kapitalit aksionar, i barabartë ky me 95 (nëntedhjetë e pesë) pjesë-kuota me vlerën 39,900,000 (Tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind mijë) Lekë dhe z. Roland KOCLI zotëron 5 % të kapitalit aksionar, i barabartë ky me 5 (pese) pjesë-kuota me vlerën 2,100,000 (Dy milion e njëqind mijë) Lekë, ku secila kuotë ka vlerën prej 420,000 (Katerqind e njëzet mijë) Lekë;

Me Vendimin Nr. 21, datë 28 Prill 2021, Asambleja e Ortakeve e Shoqërisë ka vendosur:

- Miratimin e llogarive vjetore të Shoqërisë Tregtare "ALBIT CONSTRUCTION" Sh.p.k. Lac për vitin financiar 2020 të mbyllur me datë 31.12.2020;
- Kalimin e rezervave dhe fitimeve të pashpërndara gjendje sipas bilancit të mbyllur me 31 Dhjetor 2020 për: 1) zmadhimin e kapitalit aksionar të shoqërisë me vlerën 58,000,000 leke, 2) shtim të reserves ligjore me 2,200,000 leke , dhe 3) diferenca në vlerën prej 4,555,759 leke të mbetët gjendje për rezerva të tjera - investime ;
- Caktimin e z. Lavdimir FUSHA, anetar i Insitutit të Eksperteve Kontabel të Regjistruar, me Nr.Licence 97 date 10.01.2001, për vlerësimin e zmadhimit të kapitalit aksionar me rezervat dhe fitimet e pa shpërndara, gjendje sipas bilancit të mbyllur me 31 Dhjetor 2020;
- Caktimin e z.Lavdimir FUSHA për auditimin e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2021;
- Depozitimin e këtij vendimi pranë Qendres Kombëtare të Biznesit si dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhe.

Në vështrim të rendit të ditës, Asambleja e Ortakeve e kësaj shoqërie, pasi njihet me Raportin e Ekspertit Kontabël të Regjistruar për vlerësimin e fitimeve të pashpërndara për zmadhimin e

kapitalit aksionar të Shoqërisë të datës 08 Maj 2021, i përgatitur nga Eksperti Kontabël i Regjistruar z. Lavdimir FUSHA, vëren se ky raport është i drejtë, në përputhje me ligjet në fuqi dhe për këto arsye duhet miratuar.

Sipas këtij raporti, zmadhimi i kapitalit aksionar të shoqërisë bëhet nga 42,000,000 (Dyzet e dy milion) Leke në 100,000,000 (Njëqind milion) Leke, e barabartë kjo me 100 (Njëqind) kuota (pjesë) kapitali, secila me vlerë nominale prej 1,000,000 (Një milion) Lekë. Pra, numri i kuotave (pjesëve) të kapitalit aksionar mbetet i pandryshueshëm dhe vetëm vlera nominale e tyre rritet.

Ky kapital do të zotërohet nga Ortaket në këto raporte:

z. Luan MARNOJ, do të jetë përsëri zotërues i 95 % të kuotave të kapitalit aksionar, i cili do të përbëhet nga 95 (nentedhjetë e pesë) kuota (pjesë) kapitali me vlerë 95,000,000 (Nentedhjetë e pesë milion) Leke nga ku secila kuotë (pjesë) do të ketë vlerën nominale prej 1,000,000 (Një milionion e teteqindenedhjetë mijë) Lekë.

z. Roland KOCLI, do të jetë përsëri zotërues i 5 % të kuotave të kapitalit aksionar, i cili do të përbëhet nga 5 (pesë) kuota (pjesë) kapitali me vlerë 5,000,000 (Pesë milion) leke nga ku secila kuotë (pjesë) do të ketë vlerën nominale prej 1,000,000 (Një milion) Lekë.

Për këto arsye, Asambleja e Ortakeve, pas shqyrtimit të rendit të ditës;

V E N D O S I

1. Miratimin e Raportit të Ekspertit për vlerësimin e fitimeve të pashpërndara për zmadhimin e Kapitalit Aksionar të Shoqërisë të datës 08 Maj 2021 të përgatitur nga z. Lavdimir FUSHA, Ekspert Kontabel i Regjistruar;
2. Zmadhimin e Kapitalit Aksionar të kësaj shoqërie nga 42,000,000 (Dyzet e dy milion) Leke në 100,000,000 (Njëqind milion) Leke, e barabartë kjo me 100 (Njëqind) kuota (pjesë) kapitali;
3. Numri i kuotave (pjesëve) të kapitalit, mbetet i pandryshueshëm, dhe rritet vetëm vlera nominale e tyre;
4. Vlera e çdo kuote (pjesë) kapitali kalon nga 420,000 (Katerqind e njetzet mijë) Leke në 1,000,000 (Një milion) Leke ;
5. **z. Luan MARNOJ**, do të jetë përsëri zotërues i 95 % të kuotave të kapitalit aksionar, i cili do të përbëhet nga 95 (nentedhjetë e pesë) kuota (pjesë) kapitali me vlerë 95,000,000 (Nentedhjetë e pesë milion) Leke nga ku secila kuotë (pjesë) do të ketë vlerën nominale prej 1,000,000 (Një milionion e teteqindenedhjetë mijë) Lekë.
6. **z. Roland KOCLI**, do të jetë përsëri zotërues i 5 % të kuotave të kapitalit aksionar, i cili do të përbëhet nga 5 (pesë) kuota (pjesë) kapitali me vlerë 5,000,000 (pesë milion) Leke nga ku secila kuotë (pjesë) do të ketë vlerën nominale prej 1,000,000 (Një milionion e teteqindenedhjetë mijë) Lekë.
7. Depozitimimin e këtij vendimi pranë Qendres Kombëtare të Biznesit .

ASAMBLEJE E ORTAKEVE E SHOQËRISË TREGËTARE

"ALBIT CONSTRUCTION" SH.P.K LAC

ROLAND KOCLI

LUAN MARNOJ

